



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Mbledhja nr. 63/2022

Prishtinë, më 7.6.2022, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Jeta Statovci, nënkryetare e parë, Fidan Jilta, nënkryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku- Rexhepi, Ljubinko Karaxhiq dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Munguan: Ferat Shala, kryetar, Driton Hyseni dhe Abelard Tahiri, anëtarë.

Pjesëmarrës tjerë: Reshat Nurboja, kabineti i kryetarit të Kuvendit; Festim Bytyçi, GPAAK; Ermira Llapashtica-Zeka, Kuvend/media; Valon Bedrolli praktikant, Kuvend dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Denis Berisha, (praktikant D+).

Mbledhjen e kryesoi Jeta Statovci, nënkryetare e parë e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 24.5.2022;
3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-075 për markat tregtare;
4. Informatë lidhur me vizitën zyrtare të Komisionit në Tiranë/Shqipëri 29-31 maj 2022;
5. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.5.2022

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 24.5.2022, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-075 për markat tregtare

Kryesuesja theksoi se projektligji për markat tregtare i ka kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit në komision dhe komisionet e përhershme, andaj, në pajtim me nenin 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, e procedojmë për lexim të dytë. Mirëpo, paraprakisht, jam njoftuar nga stafi se në amendamentin 56, duhet një ndryshim teknik, ku “në vend të nenit 91, të shënohet neni 92, pa cenuar fare përmbajtjen e amendamentit 56”, sepse sipas administratës, në spastrim të projektligjit është riradhitur si i tillë, pra është vetëm ndryshim teknik, andaj kërkoj që raporti me rekomandime të miratohet me këtë ndryshim.

Komisioni unanimisht nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-075 për markat tregtare.*
- 2. Raporti procedohet për lexim të dytë në seancë plenare.*

4. Informatë lidhur me vizitën zyrtare të Komisionit në Tiranë/Shqipëri 29-31 maj 2022

Kryesuesja theksoi se në bazë të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit, duhet të njoftohet Kryesia dhe deputetët me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri. Ne, si komision, ishim në Republikën e Shqipërisë, një informatë e kemi marrë nga stafi, prandaj mund të diskutojmë lidhur me këtë informatë, nëse ka dikush. Temat kryesore të diskutimit gjatë kësaj vizite kanë qenë: monitorimi i zbatimit të marrëveshjeve të të dy qeverive tona, lehtësimin e mundësive të bashkëpunimit në fushën e ekonomisë, industrisë, energjisë, tregtisë, ndërmarrësisë; formën dhe mënyrën e raportimit të agjencive të pavarura dhe rregullatorëve të tregut që i raportojnë Parlamentit; sfidat me të cilat përballen bizneset e të dy vendeve; legjislacioni shqiptar në kriptovaluta dhe legjislacioni në mbështetjen e start up-ve, etj. Njëkohësisht ka pasur edhe tema tjera të ndryshme të cilat janë diskutuar me palët prezentë. Gjatë vizitës, Komisioni është takuar me Komisionin homolog për Ekonomi dhe Financa, me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, me Komisionin për veprimtaritë prodhuese, tregtinë dhe mjedisin, me Qendrën Kombëtare të Biznesit, me nënkryetaren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë të Shqipërisë, me Entin Rregullator të Energjisë, me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, takim me ministren e Ekonomisë dhe Financave.

Valentina Bunjaku- Rexhepi, potencoi se vizita ka qenë me përmbajtje jashtëzakonisht të mirë, prandaj të vazhdojmë me bashkëpunimin, të shkëmbejmë praktikën e mira me Shqipërinë, dhe ta konkretizojmë me rezultat këtë vizitë, e mos të mbetet vetëm vizitë në letër. Gjatë vizitës në takimet e realizuara kemi dhënë kontributin tonë. Pritja e delegacionit tonë ka qenë

jashtëzakonisht e mirë dhe ideja e tyre që të kemi një grup të përbashkët për bashkëbisedim dhe bashkëveprim tutje është ide e mirë që duhet të shtyhet përpara.

Mimoza Kusari- Lila, theksoi se në funksion të asaj që ne po mundohemi ta ngremë bashkëpunimin mes dy vendeve, duke hequr barrierat tregtare, duke u fokusuar në lehtësimin e të bërit biznes dhe sinkronizimin e legjislacionit. Pas kthimit nga vizita në Shqipëri, kam kontaktuar me koordinatorin e përbashkët të dy qeverive, z. Gentian Sala dhe e kam përcjellë njoftimin që Komisioni për Ekonomi i Parlamentit të Kosovës, përveç që kemi diskutuar për projektligjin për kriptovalutat dhe projektligjin për start-up, kemi diskutuar edhe për projektligjin e tregjeve të kapitalit. Gjatë vizitës së Qendrës kombëtare të biznesit kemi ngritur çështjen e procedurave të tejzgjatura të regjistrimit bizneseve apo filialeve të bizneseve të Shqipërisë në Kosovë apo anasjelltas dhe është vlerësuar se ka nevojë për ndryshim në legjislacionet respektive. Propozoj që t'ia përcjellim Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë informacionin të cilin ne e kemi diskutuar edhe me ministren e Financave dhe Ekonomisë, por edhe me qendrën kombëtare të regjistrimit të bizneseve në Tirana që të identifikohen nenet e Ligjit për shoqëritë tregtare, të cilat duhet të harmonizohen. Propozoj gjithashtu që në të ardhmen e afërt të kemi një tryezë të përbashkët me Entin Rregullator të Energjisë të Shqipërisë, Zyrën e Rregullatorit të Energjisë të Kosovës, me qëllim të bashkërendimit të politikave rregullatorë dhe fuqizimit të strategjisë së energjisë, që të gjejmë format më të mira të bashkëpunimit në kuadër të energjisë. Nismat legjislative dhe bashkëpunimet mes dy parlamenteve të fillojnë të reflektohet edhe në agjendën e takimeve të dy qeverive.

Armend Muja, theksoi se jam përkrahës i madh i shkëmbimit të përvojave dhe bashkërendimit mes dy vendeve, Kosovës dhe Shqipërisë. Duhet të sqarojmë rreth prioriteteve të veçanta dhe këtu domosdoshmërisht është prioritet i parë është bashkëpunimi për energji sepse tash kemi një treg të përbashkët energjetik. Tjetra është shqyrtimi i mundësive për shkëmbim energjetik dhe mendoj që kjo është një strategji dalëse e Kosovës, por është mirë edhe për Shqipërinë, përfshirë këtu edhe bashkëpunimin në çdo plan që ata kanë, sa i përket energjisë së ripërtëritshme. Ai tha se shtylla e dytë e bashkëpunimit i përket tregut të përbashkët rajonal dhe iniciativës së tregut të përbashkët, në kuadër të procesit të Berlinit, këtu e kam theksin tek tri liritë themelore. E para është shkëmbimi i mallrave, ku ka ende vështirësi, dhe ne kemi miratuar si Kuvend dy marrëveshje ndërkombëtare për lehtësim të këtij procesi dhe njëri prej tyre është porti i Durrësit dhe e dyta është pika e përbashkët doganore në portin e Durrësit, pastaj edhe vështirësitë që i kanë bizneset e Kosovës apo edhe anasjelltas, sa i përket tranzicionit doganor dhe kjo duhet të përcillet së bashku me doganat. Në kuadër të prioritetit të dytë është mobiliteti i fuqisë punëtore. Ne i kemi miratuar disa ligje e vendime që i largojnë këto pengesa dhe kur të lëvizë fuqia punëtore, të ketë mundësinë e probabilitetit të pensioneve. Çështja tjetër referuar Procesit të Berlinit është sa i përket mobilitetit të lirë të shërbimeve të arkitektëve, ndërtimtarëve, mjekëve dhe të gjitha profesioneve që janë paraparë te Procesi i Berlinit. E fundit është shkëmbimi i lirë i kapitalit dhe mendoj që ka hapësirë të punohet edhe për një bursë rajonale ose shqiptare. Ligji i tregjeve të kapitalit është një shembull i mirë, por duhet të tentojmë të ofrojmë intensifikim të bashkëpunimit në mobilitet të kapitalit. Në prioritetin e tretë, beson tek ujërat dhe Shqipëria në krahasim me Kosovën ka shumë ujë dhe ne duhet të gjejmë forma të bashkëpunimit. Po ashtu, tjetra është turizmi dhe infrastruktura, si dhe infrastruktura teknologjike 5G/6G. Kjo duhet të jetë tematikë e veçantë e bashkëpunimit tonë. Mendoj se i kemi diku 20 marrëveshje me Shqipërinë, shumica e këtyre marrëveshjeve nuk po përcillen nëse janë duke u implementuar. Njëra prej

marrëveshjeve, e cila kisha rekomanduar të futet si prioritet, është themelimi i një regjistri të përbashkët shqiptar të regjistrimit të bizneseve dhe aty duhet të punohet bashkërisht. Mendoj se secili deputet duhet të marrë nga një çështje, në mënyrë që të mbahet gjallë bashkëpunimi. Ai tha se nuk duam të përfundojë vetëm me një vizitë, por duhet ta kultivojë këtë në baza javore, mujore apo vjetore.

Pal Lekaj, tha se sa i përket vizitës, mendoj se ka qenë përmbajtësore. Ajo që më ka bërë përshtypje është se kemi mbi 90 marrëveshje nga takimet mes dy qeverive, mirëpo deri më sot, është minimumi i implementimit të atyre marrëveshjeve. Pajtohem që ne të kemi një trup që i mbikëqyrë këto marrëveshje dhe së bashku me diplomacinë ndërkombëtare, ne mund t'i shtyjme këto gjëra dhe të jemi shumë më aktiv. Të gjitha qeveritë nuk i kanë kushtuar vëmendje implementimit të marrëveshjeve. Ne kemi bërë takime, kemi bërë marrëveshje, por nuk i kemi jetësuar. Janë tri fusha kryesore që mund të fokusohemi: ajo e energjisë, e infrastrukturës tokësore, dhe ajo që është jetike, është gazi në fushën e energjisë. Është përmendur se do të kemi një hekurudhë prej Gjakovës deri në Shkodër, atëherë mund ta përdorim edhe si trase për gaz. Ne mund t'i shtyjme këto gjëra, sepse nëse ngecim në këtë drejtim, atëherë Kosova duhet të mendojë për alternativa për energji. Kemi debatuar për gazin nga Maqedonia, që fatkeqësisht nuk kemi mbërri në ndonjë marrëveshje dhe kjo nuk do të thotë se duhet të ndalemi së shikuari alternativa të tjera. Mendoj se është e drejtë dhe e udhës që krahas hekurudhës, ta shfrytëzojmë infrastrukturën edhe sa i përket trasesë së gazit. I kemi dëgjuar përvojat që i kanë pasur ata, sidomos te rregullatori i energjisë, tek i cili pamë praktika të mira, me të cilat iu kanë qasur situatës, krizës energjetike dhe bashkëpunimi sa ma i ngushtë me ta, aq më mirë.

Kryesuesja theksoi se janë trajtuar një varg çështjesh, si në raport me bashkëpunimin, në kuadër të legjislacionit, ku u përmend edhe çështja e kriptovalutave, grave në biznes, start up-ve, por edhe tematika që lidhen më shumë me Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë, në çështjen e regjistrimit të përbashkët të shoqërive tregtare dhe ndryshimeve legjislative në raport me lehtësirat e nevojshme, që mos të ketë duplikim të procedurave. Po ashtu, u përmend çështja e energjisë, identifikimi i mundësive dhe lehtësirave doganore, mobiliteti i punëtorëve, tregjet kapitale, gjithashtu edhe infrastruktura. Staf i mbështetës i Komisionit ka qenë bashkë me neve dhe ka përcjellë të gjitha kërkesat dhe të gjitha dakordimet që kemi pasur në kuadër të mbledhjes dhe i falënderojmë për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e tyre. Hapi i radhës do të ishte përgatitja e një kalendari, ku ndahen tematikat potencialisht edhe deputetët në bazë të interesit të tyre dhe do të mund të zërthehej edhe në aktivitete. Nëse është trajtuar çështja e regjistrimit të bizneseve, mund të caktohet si aktivitet i veçantë. Hap i ardhshëm do të jetë përgatitja e listës së rekomandimeve, e cila i përcillet ministrisë përkatëse. Në këtë mënyrë, mund të ndahemi në kuadër të fushave të cilat i përcjellim dhe të dakordohemi për datat se kur mund t'i organizojmë këto diskutime.

Armend Muja, tha se do të diskutojë për çështjen e “Ballkanit të hapur”. Ai tha se ne kemi iniciativën e tregut të përbashkët rajonal, me arbitër të ndershëm, Bashkimin Evropian, me rregulla të BE-së, me orientimin strategjik të BE-së. Po ashtu, kemi projektin paralel që quhet “Ballkani i hapur”, i cili siç mësuam nga Lavrov dhe e kemi ditur edhe ne, është iniciativë e Serbisë. Paralelisht, na mbetet po ashtu të eksplorojmë bashkëpunimin ndërmjet një ombrelle, siç është BE-ja, që është edhe synimi ynë strategjik, por në anën tjetër i ka rregullat e definuara, ka fuqi kushtëzim, dhe stimulimi, sa i përket këtyre masave. Kemi një iniciativë tjetër që besoj është

derë e hapur për të rritur influencën e Lavrov-it dhe Kinës në Ballkan. Çuditërisht, ka pasur zëra se ky modelim i bashkëpunimit apo “Ballkani i hapur” është modeluar në përvojën franko-gjermane dhe problemi kryesor është së kjo gjë është e pasaktë. Për këto arsye, është mirë ky që komision ta diskutojë edhe këtë çështje. Franca dhe Gjermania, kur kanë filluar bashkëpunimin, fillimisht kanë adresuar problemet nga e kaluara, krimet e së kaluarës dhe ka pasur një arbitër të ndershëm, i cili nuk ka qenë nga BE-ja dhe çështja tjetër është se nuk ka pasur dilema të sigurisë. Besoj se tregtia ndihmon paqen mes njerëzve, megjithatë ajo nuk e zgjidh dilemën e sigurisë. Rusia dhe Ukraina kanë qenë partnerë shumë të afërt tregtar, por nuk e kanë zgjidhur dilemën e sigurisë së Ukrainës, dhe për këtë arsye, është e rëndësishme që ky komision dhe komisionet gjegjëse ta promovojnë tregun e përbashkët rajonal, në kuadër të BE-së, si projekt strategjik për shqiptarët në Ballkan.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, propozoi që të caktohen temat, si për shembull, ZRRE-ja apo energjia në këtë rast, projektligji për kriptovaluta dhe ndonjë temë tjetër që del bashkërisht dhe pastaj administrata ta procedojë tutje, të cilët e shfrytëzoj rastin t’i falënderoj, sepse në takime të kësaj vizite, kanë qenë jashtëzakonisht të kujdesshëm dhe e kanë kryer punën e vet ndershëm, si administratë. T’i caktojmë tri tema dhe pastaj ne si deputet të ndahemi në to, por jo të ketë shumë tema, sepse pastaj nuk mund të japim kontribut dhe të mbetet vetëm në letër ajo temë e caktuar.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë:

Përfundim

Komisioni këtë vizitë e vlerëson si mjaft të suksesshme, së bashku me komisionin homolog, u nxorën këto përfundime, si vijon:

- *Të shkëmbehen agjendat e komisioneve dhe dy Kuvendeve, kur ka tema me interes nga secila palë;*
- *Të shkëmbehen dhe të merren përvojat e secilit komision parlamentar, me rastin e shqyrtimit të projektligjeve;*
- *Të mbahen mbledhje të përbashkëta të komisioneve, ku do të raportonin ministrat e dy qeverive për nivelin e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara;*
- *Të diskutohet në takime të përbashkëta për strategjitë dhe dokumentet e rëndësishme me rastin e shqyrtimit në komisione (energjia, uji, transporti, hekurudha, dogana etj.);*
- *Të evidentohen barrierat ligjore në legjislacionet përkatëse që krijojnë barriera tarifore dhe jo-tarifore për bizneset;*
- *Të përkrahen dhe të mbështeten iniciativat strategjike të dy qeverive nga ana e komisioneve parlamentare;*
- *Të mbahen mbledhje të përbashkëta në mes komisioneve, për të parë realizimin e konkluzioneve nga takimi në takim;*
- *Dy administratat e komisioneve parlamentare të përcjellin të njëjtin përkushtim dhe bashkëpunim, sikurse komisionet.*

Bazuar për sa u cek më sipër në përfundim, Komisioni nxori këto:

Rekomandime

- *Ministritë përkatëse të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë, me qëllim të thjeshtimit të proceduarave për regjistrimin e bizneseve, të bëjnë ndryshimet ligjore në legjislacionin përkatës për shoqëritë tregtare, që të eliminohen ato dispozita që janë barriera për bizneset, si dhe të hapet rrugë që të ketë shkëmbim të informatave apo edhe përcjellje të drejtpërdrejtë të listës së bizneseve të regjistruara në Kosovë dhe ato në Shqipëri, me idenë që të mos kalohet në procedurën e kërkesës së noterizuar, të vulës apostile etj., por të ekzistojë një komunikim dhe një format më i lehtë i regjistrimit të filialeve të bizneseve respektive, në dy anët e kufirit, dhe mundësia e regjistrimit të përbashkët të bizneseve, si dhe bashkëpunimi në hartimin e legjislacionit në mes dy komisioneve homologe në fushën e start up-ve dhe bizneset e grave;*
- *Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë dhe Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri, të organizojnë tryezë të përbashkët, për të diskutuar mbi bashkërendimin dhe fuqizimin e zbatimit të strategjisë së energjisë, dhe të gjejnë format e harmonizimit apo çfarëdo që është e mundur në kuadër të legjislacioneve respektive, që të tejkalohe pengesat e mundshme;*
- *Operatorët e sistemit të transmisionit dhe tregut të energjisë “KOSTT” në Kosovë dhe “OST” në Shqipëri, të bashkëpunojnë në atë mënyrë që të liberalizohet tregu energjetik dhe të gjinden mundësitë, që sa më shpejt të funksionalizohet bursa energjetike “ALPEX”;*
- *Ministritë përkatëse të financave dhe doganat e dy vendeve të punojnë në atë drejtim për të funksionalizuar pikat e përbashkët doganore në portin e Durrësit;*
- *Qeveritë e dy vendeve të prioritetizojnë mobilitetin e fuqisë punëtore, si shërbimet e arkitektëve, ndërtimtarëve, mjekëve dhe të gjitha profesioneve të lira, që janë paraparë te Procesi i Berlinit dhe t’i evitojnë pengesat ligjore, pastaj të punohet edhe në mundësinë e portabilitetit të pensioneve;*
- *Qeveritë tona të punojnë në atë drejtim të përmirësimit në legjislacionin për tregjet e kapitalit, por duhet të tentohet të ofrohet intensifikimi i bashkëpunimit në mobilitet të kapitalit;*
- *Rregullatori i Komunikimeve Elektronike në Kosovë, ARKEP dhe në Shqipëri AKEP, duhet të gjejnë forma të bashkëpunimit, për avancimin dhe ngritjen e infrastrukturës dhe teknologjinë 5G/6G.*

5. Të ndryshme

a) Njoftim për pjesëmarrjen në Konferencën e SEECP-së, 1-2 qershor 2022, në Athinë, nënkryetarja Jeta Statovci

Kryesuesja Jeta Statovci njoftoi deputetët, lidhur me vizitën e realizuar më datë 1 dhe 2 qershor 2022, në Athinë, ku ka marrë pjesë në Konferencën e SEECP-së, në cilësinë e nënkryetares së Komisionit. Janë tri komisione, të cilat përfaqësohemi, si: ekonomia, siguria dhe arsimit. Temat

kanë qenë me sigurinë, stabilitetin ekonomik, agrikulturën dhe energjinë. Delegacioni i Kosovës e ka marrë kryesimin e dy komisioneve, Komisionin për Arsim dhe Komisionin për Siguri, ndërsa më parë e kemi pasur Komisionin për Ekonomi. Kjo ishte një dakordancë mes palëve. Rezoluta është miratuar në kuadër të kryetarëve të parlamenteve të 13-të shteteve pjesëmarrëse.

Pal Lekaj, pyeti sesi ishte trajtimi i Kosovës në këtë konferencë më fusnotë apo si Prishtina. -A ka qenë e përfaqësuar opozita?

Kryesuesja, tha se shteti ynë është trajtuar sikurse shtetet tjera, i barabartë, madje siç njoftova, do t'i kryesojmë disa komisione. Po ashtu, është hera e parë që në Kuvendin grek shkel një delegacion i Kosovës. Nuk kemi vërejtur se jemi trajtuar ndryshe, përveç sikurse krejt shtetet tjera. Po ashtu, njoftoi se në këtë konferencë ka qenë i ftuar kryetari i Komisionit, që është opozitë, por nuk ka marrë pjesë.

b) Njoftim për pjesëmarrjen në Forumin e 27-të të energjisë elektrike, më 1 dhe 2 qershor 2022, në Athinë”, deputetja Mimoza Kusari - Lila

Mimoza Kusari – Lila, lidhur me pjesëmarrjen në Forumin e 27-të të energjisë elektrike, më 1 dhe 2 qershor 2022 ,në Athinë, tha se me ftesën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë kam marrë pjesë në këtë forum, i cili ka pasur në agjendë çështjet e sigurisë dhe furnizimit me energji, si pasojë e luftës në Ukrainë, integrimi i sistemeve dhe pavarësia e tyre energjetike, në veçanti, ai i Ukrainës dhe Moldavisë. Një prej paneleve ku unë kam qenë folëse, kishte të bënte me politikën e dekarbonizimit apo zbatimit të politikave me energji të pastër. Në panel kam prezantuar parametrat të cilët Qeveria e Republikës së Kosovës është duke i planifikuar me strategji, sipas së cilës deri më 2030, parashihet që 1400MW të jenë kapacitete me energji të ripërtëritshme.

c) Ftesa për të vizituar Kosovën, komisionit homolog për Energji në Kuvendin e Ukrainës

Mimoza Kusari – Lila, njoftoi se gjatë takimit të Plenumit parlamentar të Komunitetit të Energjisë, më 17 dhe 18 maj, në Bruksel, kemi diskutuar me delegacionin nga Komisioni homolog i Ukrainës, në fushën e energjisë, që sipas mundësive të tyre ta vizitojnë Kosovën dhe ta vazhdojmë bashkëpunimin mes dy komisioneve. Kryetari i Komisionit Ferat Shala i ka dërguar ftesën kryetarit të Komisionit homolog nga Ukraina, për vizitë në Kosovë, por ende nuk kemi marrë përgjigje. Për zhvillimet e mëtejshme rreth kësaj ftese do t'ju mbajmë të informuar dhe do ta përpilojmë agjendën.

d) Realizimi i planit të punës për muajin maj

Kryesuesja përmendi punët që janë realizuar dhe ato që janë në proces. Në proces janë nismat legjislative për kriptovaluta dhe nisma legjislative për rregullimin e shërbimeve të ujit. Ka nisma ligjore që nuk kanë filluar ende. Disa tryeza nuk janë realizuar ende. Dy projektligje nuk kanë ardhur ende nga Qeveria. Në proces është edhe monitorimi i zbatimit të Ligjit për Trepçën.

Armend Muja, theksoi se nisma legjislative për Projektligjin për rregullimin e shërbimeve të ujit është në proces, kemi mbajtur takime, e kemi një draft fillestar, dhe në ditët në vijim, planifikojmë të mbajmë një debat publik. Për mbështetje të grupit punues për Projektligjin për

rregullimin e shërbimeve të ujit, propozoj të angazhojmë një ekspert. Po ashtu, edhe për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Trepçën, propozoj të angazhojmë një ekspert për hartimin e rekomandimeve. Kërkoj që deri në mbledhjen e radhës të propozohen kandidatët për ekspertë, që do të angazhohen në çështjet e lartpërmendura.

Pal Lekaj pyeti: çka u bë me nismën për Projektligjin për mbylljen e AKP-së?

Mimoza Kusari - Lila, tha se ta kërkojmë koncept - dokumentin e Fondit sovran, që e ka miratuar Qeveria, ta trajtojmë atë dokument dhe mandej të shohim hapat e mëtejme lidhur me Projektligjin për mbylljen e AKP-së.

Komisioni aprovoi propozimin e z. Muja për angazhim të një eksperti për Projektligjin për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe një eksperti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Trepçën.

e) Kërkesa për takim me Odën e Afarizmit të Kosovës

Kryesuesja njoftoi se Oda e Afarizmit të Kosovës ka kërkuar takim me Komisionin për të diskutuar lidhur me prioritetet për këtë vit dhe paraqitja e nevojave dhe kërkesave të komunitetit të biznesit, si dhe mundësitë e bashkëpunimit.

Komisioni vendosi që takimi të mbahet ditën kur mbahet mbledhja e Komisionit.

f) Valentina Bunjaku - Rexhepi, propozoi që të vizitohen disa biznese prodhuese dhe eksportuese në Komunën e Gjilanit dhe ndërmarrja publike “Hidromorava”. Vizita të realizohet të martën e ardhshme, ditën kur kemi mbledhje të Komisionit, madje mbledhjen mund ta mbajmë në Gjilan.

Komisioni miratoi propozimin e deputetes Bunjaku-Rexhepi.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Jeta Statovci,

Nënkryetare e parë e Komisionit